



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Data**  
07.12.2020

#### RELACION

#### **PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË DHOMËS SË FSHEHTË QË DO TË PËRDORET NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Bazuar në parashikimet e nenit 99, paragrafi 2, shkronja “c”, nenit 100, paragrafi 1 shkronja “ç”, dhe nenit 101, paragrafi 1 shkronja “a” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të gjithë Qendrat e Votimit pajisen me dhoma të fshehta, të cilat garantojnë që zgjedhësi të kryejë shënimin në fletën e votimit në fshehtësi të plotë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të parashikimeve të dispozitave sipërcituar, ka detyrimin të pajisë KZAZ me numër të mjaftueshëm fhomash të fshehta, dhe më pas KZAZ ja shpërndan ato qendrave të votimit nën juridiksion.

Referuar eksperiencës të organizimit dhe administrimit të proceseve zgjedhore, dhomat e fshehta, sipas specifikimeve teknike të miratuara nga KQZ, kanë garantuar fshehtësinë e votimit, kanë qenë të përshtatshme për zgjedhësin gjatë shënimit të fletës së votimit, si dhe kanë ofruar lehtësi për komisionerët në organizimin e qendrës së votimit.

Projektvendimi i paraqitur, parashikon të njëjtin model dhe specifikime për dhomat e fshehta që do të përdoren për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore  
Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor  
Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm

